

TAGE DER DEUTSCHEN SPRACHE

8—20 maj
Ditët e Gjuhës Gjermane

DIE KUNST

8—20 maj
Dani nemačkog jezika

DIE KULTUR

8—20 May
Days of the German language


8—20 MAI 2022 KOSOVO

8—20 MAJ DITËT E GJUHËS GJERMANE

Ambasada Gjermane, së bashku me Ambasadën Austriake dhe Ambasadën Zvicëranë, si dhe Goethe Zentrum dhe OeAD, Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të Universitetit të Prishtinës dhe parterë të tjerë çdo vit në maj i organizojnë Ditët e Gjuhës Gjermane.

Me një seri ngjarjesh çdo vit në Kosovë festohet gjuha gjermane dhe prezantohen oferta të aktiviteteve të larmishme kulturore dhe mësimi të gjuhës.

FACEBOOK.COM/
TDDSKOSOVO/



Federal Department of Foreign Affairs FDFA

PROGRAMI

08.05.2022 E DIEL

NGA 13:00 FESTIVALI ERDHLEZETI

Bashkohuni me ne më 8 maj për të festuar ardhjen e verës, dimri do të ketë kaluar – është një festë e lagjes!

Festivali Erdhlezeti ofron një program ndërkombëtar për adhuruesit e muzikës.

Vendi: para Dit' e Nat', biletat i gjeni në Dit' e Nat' ose online përmes rave-travel.com

10.05.2022 E MARTË

NGA 10:00 DITA E DYERVE TË HAPURA NË DEPARTAMENTIN E GJUHËS GJERMANE, UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane i Universitetit të Prishtinës ju fton në Ditën e Dyerve të Hapura, gjatë së cilës do të prezantohen programet e studimeve BA dhe MA, projekte të DAAD-së dhe OEAD-së me studentë, si dhe bursa ERASMUS+ nga universitete në rajonin gjermanofolës.

Vendi: Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane i Fakultetit Filologjik, Universiteti i Prishtinës

12.05.2022 E ENJTE

11:00 LEXIM DHE DISKUTIM ME AUTOREN E ROMANIT “ACH MEIN KOSOVO” MECHTHILD HENNEKE

Shkrimtarja gjermane Mechthild Henneke do të prezantojë librin e saj „Ach, mein Kosovo“. Heroi i romanit „Ach, mein Kosovo“ i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1998 dhe duke qenë mjek i ri, i duhet ta zëvendësojë stetoskopin me pushkë. Para se t' shkojë në luftë, Taras Galani ka jetuar disa vjet në Gjermani. Romani i Mechthild Henneke bazohet në ngjarje të vërteta dhe trajton tema të kohës tonë: luftën, arratisjen dhe jetën në mes dy kulturave.

Vendi: Autostrada Biennale Hangar, Prizren

14.05.2022 E SHTUNË

20:00 AUTORE GJERMANOFOLËSE NË BISEDË BRENDË FESTIVALIT POLIP, PRISHTINË

Në kuadër të Festivalit Polip në Prishtinë, 13—15 maj, autorët nga rajoni gjermanofolës do të prezantojnë veprat e tyre. Autorja gjermane Mechthild Henneke do të prezantojë librin e saj „Ach mein Kosovo“ gjatë një diskutimi, ku do të merr pjesë edhe autorja austriake Petra Nagenkögel.

Vendi: Teatri Oda, Prishtinë

16.05.2022 E HËNË—E MËRKURË

AB 10:00 DITA E DYERVE TË HAPURA E GOETHE—ZENTRUM

Nga 16-18 maj Goethe-Zentrum do t'i hapë dyert për të gjithë të interesuarit. Këtu mund të informoheni në hollësi lidhur me ofertat e Goethe-Zentrum.

Vendi: Goethe Zentrum, Prishtinë

16.05.2022 E HËNË

18:00 SHFAQJE FILMIKE: „SAMI, JOE UND ICH“ NGA KARIN HEBERLEIN (ZVICËR)

Sam, Joe dhe Leyla e përbëjnë një grup të vajzave të pandashme. Duke folur dhe qeshur ato bredhin nëpër aglomeratet e Zuerichut. Fundin e kohës së përbashkët shkollorë duhej ta shënonte fillimi i një vereje emocionuese, mirëpo adoleshenteve shumë aktive iu duhet të ballafaqohen me disa të papritura.

Në vazhdim të shfaqjes, raund diskutimi me temë: „Diaspora në kinema: Promovimi i imazhit të Kosovës në vende gjermano-folëse Panelistë: Astrit Alihajdaraj (KOS/AUT) dhe Ilir Hasanaj (KOS/CH)

Vendi: Kino Armata, Prishtinë

17.05.2022 E MARTË

PËRURIMI I SALLËS SË GJERMANISHTES NË SHKOLLËN PARTNERE NË FERIZAJ

Me mbështetje të Goethe-Institut-it në shkollën partnere SHFMU Vezir Jashari në Ferizaj është zgjeruar salla e gjermanishtes. Tani shkolla i ka kushtet teknike dhe hapësina për të ofruar mësim të gjermanishtes të orientuar nga veprimi, pjesëmarrja dhe kompetencat.

Vendi: SHFMU Vezir Jashari, Ferizaj

18:00 PREMIERA NË KOSOVË E FILMIT „GROSSE FREIHEIT“ (AUSTRI/GJERMANI 2021)

Në Gjermaninë represive të pasluftës Hansin e burgosin në vazhdimi për shkak të homoseksualitetit të tij. Në burg ai e takon Viktorin që është i dënuar për vrasje. Antipatia reciproke ndër vite shndërrohet në dashuri. E shtrirë në tri nivele kohore, drama gjermano— austriake e trajton një kapitull të errët të historisë së drejtësisë federale gjermane.

Çmimet (përzgjidhje): Festival de Cannes 2021, Un Certain Regard: Çmimi i jurisë; Kandidat zyrtar i Austrisë për Academy Award: Best International Film (shortlisted); Viennale 2021: Çmimi Vinez Film, Erste Bank Mehrwert Filmpreis.

Vendi: Kino Armata, Prishtinë

18.05.2022 E MËRKURË

10:00 NGJARJE VIRTUALE: STUDIMET DHE KËRKIMET SHKENCORE NË RAJONIN GJERMANOFOLËS ME OFERTË TË BURSAS

Gjatë ngjarjes informative virtuale me temë „Studimet dhe kërkimet shkencore në rajonin gjermanofolës“ ju mund të informoheni rreth mundësive për studime dhe bursa në Gjermani, Austri dhe Zvicër.

Në vazhdim ekziston mundësia e parashtrimit të pyetjeve.

Vendi: Virtual, linku në facebook.com/TddSKosovo

NGA 10:00 KUIZI RRETH GJERMANISË

Testoni dijet tuaja rreth Gjermanisë gjatë kuizit interaktiv në Goethe-Zentrum Prishtinë. Kuizi rreth Gjermanisë do të mbahet sërish më 18 maj.

Fituesi si shpërblim do të merr një bursë për kurs gjuhe.

Vendi: Goethe Zentrum, Prishtinë

NGA 10:30 DITA E GJUHËS DHE LETËRSISË GJERMANE NË UNIVERSITETIN E PRIZRENIT

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane i Universitetit të Prizrenit i hap dyert e tij për ju. Zbuloni gjithçka rreth studimeve të gjuhës dhe letërsisë gjermane dhe takoni profesorët tuaj të ardhshëm.

Vendi: Ö-Punkt, Germanistik-Bibliothek, Universiteti i Prizrenit

11:00 LEXIM DHE DISKUTIM ME PETRA NAGENKÖGEL

Autorja austriake Petra Nagenkögel Prezanton veprën e saj „Dort: Geographie der Unruhe“ nga viti 2019.

Vendi: Ö-Punkt, Germanistik-Bibliothek, Universiteti i Prizrenit

17:00 SHFAQJE FILMIKE „DIE LETZTEN ÖSTERREICHER“ (AUSTRI, 2022)

Një fshat austriak në mes të Karpateve ukrainase: Sa të zë syri, Koenigsfeld është i rrethuar nga pylli i dendur. Shumica e popullsisë ka migruar në perëndim në vitet 1990, ndërsa shtëpitë e tyre i marrin banorët nga fshatrat fqinje. Të migrosh, apo të qëndrosh? Lukas Pittscheider i shoqëron katër protagonistë dhe familjet e tyre për një periudhë kohore prej tre vjetësh gjatë një vendimi orientues.

Vendi: Kino Lumbardhi, Prizren

19.05.2022 E ENJTE

11:00 „INOVACION NGA KOSOVA PËR TREGJET GJERMANOFOLËSE“—DISKUTIM ME ODAT EKONOMIKE

Odat ekonomike të vendeve gjermanofolëse ju ftojnë për diskutim me temë „Inovacioni nga Kosova për tregjet gjermanofolëse në Gjermani, Austri dhe Zvicër“. Na bashkohuni në diskutim!

Diskusimi mbahet në gjuhën shqipe me përkthim. Në vazhdim do të publikohet videregjistrimi.

Vendi: Kolegji UBT, Prishtinë

19:00 SHFAQJE ME FILMA AUSTRIAKË ORKESTRI MË I MIRË NË BOTË

Henning Backhaus, Austri 2020 14 minuta, gjermanisht / Ingbert, konkurron si kontrabastist në Orkestrën Shtetërore të Vjenës. Ide e gabuar.

FISCHE Raphaela Schmid, Austri 2020 17 minuta, gjermanisht / Një rit jo i zankonshëm i përshëndetjes i çon vëlla e motër në një restorant kinez. Pas vdekjes së të ëmës të tyre, të dy ndihen në faj dhe vetëm vështirë mund ta përballojnë gjendjen pa fjalë.

TIME O' THE SIGNS Reinhold Bidner, Austri 2019 8 minuta, anglisht / TIME O' THE SIGNS është një film i animuar eksperimental, i cili dokumenton rryma të shoqërisë tonë.

DIE WASCHMASCHINE Dominik Hartl, Austri 2020 24 minuta, gjermanisht / „Keine Garantie. Nur Selbstabholung“. Simoni dhe Lea, një çift i ri, duan ta shesin online lavatriçen e tyre të prishur. Hasani i përgjigjet shpalljes dhe vërtetë shkon dhe e merr lavatriçen.

Vendi: Europe House, Mitrovicë e Veriut

20.05.2022 E PREMTE

15:00 PIKNIK ME POEZI / OPEN MIKE

Di ndonjë, apo disa poezi goxha të mira dhe dëshiron t'ua mësosh të tjerëve? Merr me vete në çantë dhe eja në park! T'i lexojmë poezi njëri-tjetrit!

Të mirëseardhura janë poezitë e vetëshkuara, tekste të këngëve apo poezitë e dashurisë të autoreve/ëve të tjera/a në gjuhën tënde të preferuar.

Vendi: Parku i qytetit, Prishtinë

NGA 19:00 KONCERT PËRMBYLLËS BRENDË CHOPIN PIANO FEST PRISHTINA

Me pianistin Florian Uhlig (Gjermani)

Vendi: Amfiteatri i ri / Biblioteka Universitare, Universiteti i Prishtinës; Rezervimi i biletave përmes facebook.com/TddSKosovo

25.05.2022 E MËRKURË

NGJARJE BONUS 12:00 „MEMORY WALK“, SHETITJE HISTORIKE NËPËR PRISHTINË

Me fillim nga Fakulteti Filologjik, gjatë një shetitjeje të përbashkët hitorike do të vizitohen lokacione të rëndësishme historike në Prishtinë. Memory Walk mëton ta krijojë një pikënisje për një kujtim të aspekteve shpesh herë të marginalizuara të kulturës të mbamendjes dhe me këtë të ofrojë një shikim nga vendet e rëndësishme hitorike të qytetit.

Një bashkëpunim në mes të OeAD dhe ForumZFD.

Pikëtakimi: Fakulteti Filologjik, Universiteti i Prishtinës, Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Salla 29